



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
OSNOVNI SUD DJAKOVICA – BASIC COURT OF GJAKOVË

AD/GJTHGJA.nr. 06/24

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – kryetari i gjykatës Nikollë Komani, duke vendosur përkitazi me ankesën disiplinore të parashtruar nga ankuesja E. I., avokate në Prishtinë, ndaj gjyqtarës M. Sh., pas shikimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të ankesës, me datë 26 dhjetor 2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet ankesa disiplinore e parashtruar nga ankuesja E. I., avokate në Prishtinë, ndaj gjyqtarës M. Sh., si e pabazuar.

A r s y e t i m

Me datën 11 dhjetor 2024 ankuesja E. I., përmes postës ka dorëzuar ankesën disiplinore ndaj gjyqtarës M. Sh., në lidhje me lëndën C.nr.1436/23.

Pas pranimit të kësaj ankese dhe pas analizimit të përmbajtjes së saj, e njëjta është regjistruar në librin e ankesave disiplinore me numër AD/GJTHGJA.nr. 06/24 me datën 11 dhjetor 2024 dhe janë ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore që janë në kompetencë të kryetarit të Gjykatës, sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë.

Me shkresën AD/GJTHGJA.nr. 06/2024 të datës 12 dhjetor 2024, përmes email-it zyrtar është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës, për veprimet e ndërmarra lidhur me ankesën e parashtruar nga ana e ankueses.

Ankuesja E. I., në ankesën e saj të datës 11 dhjetor 2024, ka deklaruar se është përfaqësuese e palës z. Shkëlzen Pula në çështjen juridike civile të evidentuar me shenjën C.nr.1436/23, kundër të paditurit “V. I.” LLC. Sipas ankueses lënda e cila si çështje kontestimore ka kontestin e punës dhe për të cilën ligji parasheh afate më të shkurtra, gjyqtarja M. Sh. ka bërë zvarritjen e paarsyeshme të lëndës përtej afateve të përcaktuara ligjore. Ankuesja ka deklaruar se në seancën e datës 30 gusht 2024, paditësi ka dhënë fjalën e tij përfundimtare dhe sipas ligjit aktgjykimi duhet të nxjerrët në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh, që do të ishte data 14 shtator 2024. Meqenëse aktgjykimin nuk e kishin pranuar, paditësi me datë 08 nëntor 2024, përmes parashtresës kishte kërkuar që të lëshohet aktgjykimi apo të ketë sqarime lidhur me mos respektimin e afatit, bazuar në nenin 153 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Në këtë parashtresë me 20 nëntor, sipas shtojcës së bashkangjitur, paditësit i është dhënë përgjigje në email, duke sqaruar se “*gjyqtarja e çështjes ka kërkuar nga kryetari i gjykatës zgjatje të afatit për përpilimin e vendimit, për shkak të*

ngarkesave me çështje të tjera” dhe paditësi me 03 dhjetor 2024, i ka kthyer email-in duke potencuar se “afati shtesë për dy muaj e 2 javë për përpilimin e një aktgjykimi është në kundërshtim me frymën e Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe krijon pasiguri tek pala për një gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme”. Tutje, ankuesja pretendon se sipas ligjit një afat shtesë mund të kërkohet vetëm nëse çështja është e komplikuar, nëse ka shumë paditës apo ka volum të madh të provave, por pasi që çështja ka qenë kontest punë, do të duhej të trajtohej më urgjencë dhe se gjykata ka pasur mundësi që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh ta zgjidh këtë çështje. Ankuesja ka vazhduar duke shtuar se “është e paqartë se në çfarë mënyrë është kërkuar një afat shtesë prej dy muaj e njëzetë e pesë ditë për nxjerrjen e aktgjykimit. Ndonëse afati shtesë parashihet në paragrafin 3 të nenit 153 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, një afat i tillë është keqpërdorur nga gjyqtarja”. Ankuesja pretendon se me këtë zgjatje, paditësit i janë shkelur të drejtat e tij të punës, pasi që ka pritur për dy muaj e njëzetë e pesë ditë, duke i pamundësuar një gjykim të drejtë dhe brenda një kohe të arsyeshme siç përcaktohet edhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ankuesja thekson se paditësi nuk ka pasur njohuri për afatin shtesë të kërkuar dhe se për këtë është informuar vetëm në momentin kur ai e ka ngritur këtë çështje, duke shtuar se “kërkesa për afat shtesë do të ishte bërë në mënyrë të rregullt vetëm nëse e njëjta do të parashtrohej para apo në ditën e skadimit të afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh. Kjo pasi që, cili do të ishte qëllimi i njoftimit/kërkesës nëse e njëjta do të parashtrohej një muaj pas tejkalimit të afatit dhe pas rikujtimit të paditësit, se një afat i tillë është tejkaluar”. Si çështje tjetër ankuesja ka ngritur edhe pretendimin se “në aktgjykimin e pranuar me datë 09 dhjetor 2024, është shënuar se i njëjti është marr me 18 tetor 2024. Në lidhje me këtë, nga përgjigja e gjykatës së datës 20 nëntor 2024, pas një muaji nga data e vendosur në aktgjykim, është theksuar se aktgjykimi do të merret brenda një jave. Është me rëndësi të theksohet se neni 153 i LPK-së parasheh se data e marrjes së vendimit paraqet datën e përpilimit/nxjerrjes së tij. Thënë këtë, nëse gjykata ka theksuar se ende nuk është gati aktgjykimi, me 20 nëntor 2024, si është e mundur që në aktgjykim të figuroj data 18 tetor 2024, si datë e nxjerrjes së të njëjtit”. Ankuesja duke iu referuar nenit 153 paragraf 3 të LPK-së, ka theksuar se në bazë të këtij neni në rastet kur kalohet koha e caktuar gjyqtari obligohet që në pjesën hyrëse të aktgjykimit të përfshijë edhe datën e marrjes së aktgjykimit, gjë të cilën gjyqtarja nuk e ka bërë, por e ka vendosur një datë tjetër, me të cilën tenton t’i fsheh vonesat e paarsyeshme. Kjo sipas ankueses sepse “nëse aktgjykimi do të ishte nxjerr me 18 tetor 2024, atëherë gjykata në përgjigjen e saj do ta njoftonte paditësin se aktgjykimi veçse është nxjerr. Vendosja e një date të pasaktë, vërtetohet edhe nga zarfi i aktgjykimit, në të cilin evidentohet se aktgjykimi është dorëzuar në postë me 4 dhjetor 2024. Nëse do të pretendonim se aktgjykimi është nxjerr më 18 tetor 2024, atëherë si ka mundësi që i njëjti ka qëndruar në sirtar të gjyqtarës M. Sh., jo vetëm që ka tejkaluar pa asnjë arsye afatin për nxjerrjen e aktgjykimit, por në tentim për fshehje të kësaj shkele ka bërë edhe një shkelje të dytë, duke vendosur një datë paushallë si datë të nxjerrjes së aktgjykimit”. Mbi këto pretendime, ankuesja ka kërkuar që në bazë të nenit 5 par. 1 nën par. 1.2 dhe 1.3 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve, të hetohet kjo çështje dhe të merret një sanksion i paraparë në nenin 7 për shkeljet e gjyqtarës M. Sh..

Gjyqtarja M. Sh., në deklaratën e saj të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e ankueses ka theksuar se pranë kësaj gjykate ka qenë në shqyrtim çështja C.nr.1436/23 e paditësit Shkëlqim Pula, kundër të paditurës “V. I.” LLC, me objekt kontesti anulimin e vendimit dhe kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës. Gjyqtarja ka deklaruar se në këtë çështje shqyrtimi kryesor ka përfunduar me datë 30 gusht 2024 dhe në pamundësi të përpilimit të aktgjykimit brenda afatit prej 15 ditësh, bazuar në ligjin e zbatueshëm, ajo ka kërkuar afat shtesë prej 30 ditësh për përpilimin e vendimit, e cila kërkesë i është aprovuar. Afatin shtesë prej 30 ditëve e ka kërkuar për arsye se lënda ka qenë e komplikuar, në të cilën paditësi i ka kërkuar disa kërkesa dhe të gjitha ato

është dashur të analizohen, vlerësohen dhe të vendosen nga ana e gjyqtares. Gjyqtarja ka shtuar se është e ngarkuar me një numër jashtëzakonisht të madh të çështjeve në veçanti të atyre civile, arsye që të kërkonte afati shtesë në punimin e vendimeve, madje edhe për një kohë më shumë se 15 ditë, është mungesa e stafit përkatës që kanë rol ndihmës në përpilimin dhe dërgimin e vendimit me kohë. Vendimi në çështjen juridike të paditësit është marr brenda afatit ligjor shtesë dhe pastaj është vepruar në procedimin e të njëjtit të palët ndërgjyqëse, që marr parasysh ngarkesat e theksuar më lartë, i njëjti ka marr më shumë kohë se zakonisht. Ka shtuar se sa i përket email-it të dërguar nga ana e saj, përmes zyrtarit ligjor, të cilit është referuar i autorizuar e paditësit sqaron se përmes tij pala paditëse është njoftuar se për përpilimin e vendimit është kërkuar afat shtesë dhe se procedimi i vendimit do të bëhet në kohë shumë të shkurtër, që nënkupton se i njëjti është njoftuar për vonesën në dërgimin e vendimit. Duke pasur parasysh të lartcekurat ka vlerësuar se ankesa e paditësit, e ushtuar përmes të autorizuarës së tij është e pabazuar, pasi vlen të ceket se që nga koha ku si gjyqtare e çështjes është ngarkuar me këtë çështje juridike civile, ndërmarrja e veprimeve ka qenë e menjëhershme, duke u munduar në maksimum që të kontribuoj që e njëjta të përfundohet sa më shpejtë dhe sa më me pak vonesa, madje edhe në përpilimin dhe në dërgimin e vendimit të palët ndërgjyqëse, pavarësisht mbi ngarkesës së gjykatës, përkatësisht ngarkesës si gjyqtare e çështjes edhe me lëndët tjera juridiko civile.

Kryetari i Gjykatës, pas vlerësimit dhe analizimit të ankesës së ankueses, deklaratës së gjyqtares, si dhe shkresave të lëndës C.nr. 1436/2023, gjeti se **ankesa është e pabazuar**.

Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e ankueses se seanca e fundit është mbajtur me 30 gusht 2024. Afati për përpilim të aktgjykimit është 15 ditë dhe se afati i fundit për nxjerrjen e aktgjykimit do të ishte 14 shtator 2024, ndërsa kërkesa për një aftat shtesë prej dy (2) muaj e dy (2) javë për përpilimin e aktgjykimit është në kundërshtim me Ligjin për Procedurën Kontestimore dhe bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 30 gusht 2024, është konstatuar se fjala përfundimtare është dhënë në këtë seancë. Mirëpo, bazuar në shkresat e lëndës është argumentuar se është i pabazuar konstatimi i ankueses së është dhënë afat shtesë prej dy (2) muaj e dy (2) javë për përpilim të aktgjykimit. Nga shkresat e lëndës është konstatuar se gjyqtarja, ndaj të cilës është parashtruar ankesa disiplinore, me datë 18.09.2024 ka parashtruar kërkesë për zgjatjen e afatit për përpilimin e aktgjykim në kohëzgjatje prej 30 ditëve, ku me aktvendimin e kryetarit të Gjykatës është aprovuar periudha shtesë në afat prej 30 ditëve për përpilimin e këtij aktgjykimi, e ku si kërkesa e gjyqtares për zgjatjen e afatit për përpilimin e aktgjykimit, si dhe vendimi i kryetarit të Gjykatës është i bashkangjitur dhe gjendet në shkresat e lëndës C.nr.1436/2023.

Vendimi për zgjatje të afatit shtesë është marr duke u bazuar me numrin e madh të lëndëve me të cilat ka qenë e ngarkuar gjyqtarja në këtë periudhë kohore, ku bazuar në të dhënat e Sistemit për Menaxhimin të Lëndëve (SMIL), gjatë muajit shtator 2024 ka qenë e ngarkuar me 1067 lëndë kontestimore.

Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e ankueses e cila ka vënë në dyshim datën 18.10.2024 e cila është shënuar në aktgjykim si datë e përpilimit dhe nxjerrjes së aktgjykimit dhe fakti se data 18.10.2024 është datë kur është përpiluar ky aktgjykim, është argumentuar jo vetëm nga kopja fizike e aktgjykimit, e cila ju është përcjell palëve dhe gjendet në shkresat e lëndës, por edhe nga programi i SMIL-it. Për ta verifikuar saktësisht këtë fakt janë kërkuar të dhëna

nga programi SMIL-it, ku bazuar në këto të dhëna është e konstatuar se data e vendimit është 18.10.2024, si dhe dokumenti është ngarkuar me datë 18.10.2024, e për këtë si dëshmi janë edhe të gjitha këto të dhëna të printuara nga programi i SMIL-it.

Po ashtu, janë vlerësuar dhe analizuar pretendimet e ankueses se po të ishte data 18 tetor 2024, datë e nxjerrjes së aktgjykimit, si ka mundësi që i njëjti ka qëndruar në sirtar të gjyqtares dhe i është dorëzuar dorëzuesve vetëm pas një muaj dhe është konstatuar se qëndron fakti se ka pasur vonesa në dorëzimin e aktgjykimit palëve. Mirëpo, përkundër faktit se ekspedimi i vendimeve gjyqësore është detyrë e zyrtarëve të administratës është analizuar edhe puna dhe ngarkesa me lëndë që ka pasur zyra e gjyqtares gjatë kësaj periudhe kohore. Ku përpos numrit të madh të lëndëve me të cilat ka qenë e ngarkuar zyra e gjyqtares, është analizuar edhe puna e kryer nga ana e zyrës së gjyqtares gjatë kësaj periudhe kohore. Nga të dhënat e SMIL-it, konstatohet se gjatë kësaj periudhe kohore ka kryer një numër të konsiderueshëm të lëndëve dhe atë përgjatë muajit shtator, ka përfunduar gjithsejtë 108 lëndë dhe ka pasur të caktuar 42 seanca, në muajin tetor ka përfunduar 142 lëndë dhe ka pasur të caktuar 53 seanca, si dhe muajin nëntor ka përfunduar 73 lëndë dhe ka pasur të caktuar 50 seanca. Bazuar në këtë vëllim të punës është vlerësuar se vonesa në dërgimin e aktgjykimit ka qenë si rezultat i ngarkesës me lëndë dhe mungesës së stafit administrativ, e jo si rezultat i mos punës, neglizhencës së gjyqtares apo zyrtarëve të administratës, e cila do të përbënte bazë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtares.

Andaj, mbi këto baza dhe argumente vërtetohet se në veprimet e gjyqtares nuk janë konstatuar shkelje të ligjit, të cilat do të konsideroheshin shkelje disiplinore. Për këtë arsye kryetari i Gjykatës gjeti se pretendimet ankimore janë të pabazuara pasi nga të lartcekurat nuk rezulton se veprimet e ndërmarra nga gjyqtarja M. Sh., përbëjnë bazë për iniciimin e procedurës disiplinore në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Nga arsyet e theksuara më lartë, si dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 9 par. 6 të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nenit 7 par. 3 pika 3.2 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
AD/GJTHGJA.nr. 06/24, datë 26 dhjetor 2024

Kryetari i Gjykatës

Nikollë Komani

Vendimi i dorëzohet:

1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës
2. Parashtruesit të ankesës
3. Gjyqtares